

TË PËRKUSHTUAR PËR TË ARDHMEN EVROPIANE TË KOSOVËS

www.euinkosovo.eu



BE-ja në Kosovë

Mënyra më e mirë e Kosovës për t'ju afruar Bashkimit Evropian si pjesë e rajonit të Ballkanit perëndimor, është përmes ndërtimit të një Kosove demokratike dhe shumetnike me një sundim të ligjit më të konsoliduar. Kosova duhet të ketë bashkëpunim paqësor me fqinjët e saj dhe t'i kontribuojë stabilitetit rajonal dhe atij evropian. Prandaj, duhet të ndërmerren masa për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe politik dhe një të ardhme më të mirë për të gjitha komunitetet në Kosovë.

BE-ja është në Kosovë që të promovojë paqe dhe stabilitet dhe që t'i përkrahë autoritetet kosovare gjatë zbatimit të reformave të nevojshme. Të gjitha 27 shtetet anëtare të BE-së kanë rikonfirmuar mbështetjen e tyre të vazhdueshme për perspektivën evropiane të rajonit në takimin e udhëheqësve të shteteve dhe qeverive të tyre që është mbajtur në dhjetor të vitit 2008. Si rezultat i kësaj, Kosova si pjesë e rajonit, është e ngulitur fuqishëm në kornizën e procesit të stabilizim asociimit.

BE-ja vepron në përputhje me parimet e pronësisë vendore. Autoritetet kosovare e kanë përgjegjësinë që të marrin përsipër udhëheqjen dhe të punojnë rreth reformave të nevojshme. BE-ja është e gatshme që të ofrojë mbështetje politike, teknike dhe financiare për t'i ndihmuar Kosovës në rrugën drejt Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian pas Traktatit të Lisbonës

Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009 dhe solli një listë të reformave për kornizën institucionale të Bashkimit Evropian. Në fushën e politikës së jashtme u krijua pozita e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për politikën e punëve të jashtme dhe sigurisë. Për sa i përket marrëdhënieve të jashtme, përfaqësuesi i lartë ushtron funksione që deri më tani janë ushtruar nga kryesia gjashtëmujore, përfaqësuesi i lartë për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe nga komisioneri për marrëdhënie të jashtme. Catherine Ashton u emërua në këtë post në muajin nëntor të vitit 2009. Të gjitha misionet e udhëhequra nga BE-ja dhe që gjinden jashtë BE-së, duke përfshirë misionin në Kosovë, i raportojnë asaj. Komisioni Evropian e udhëheqë procesin e zgjerimit dhe Komisioneri për zgjerim Stefan Füle është duke i dhënë rëndësi të madhe Ballkanit perëndimor, përfshirë Kosovën.

Znj. Ashton e ka përgjegjësinë e themelimit të shërbimit për angazhime të jashtme që do t'i ndihmojë përfaqësuesit të lartë për të siguruar përputhshmërinë dhe bashkërendimin e veprimeve të jashtme të Bashkimit Evropian, për të përgatitur propozime të politikave dhe për t'i zbatuar ato pasi të miratohen nga Këshilli. BE-ja do të vazhdojë me praninë e saj në Kosovë deri në miratimin e reformave të ardhshme.

“Përkushtimi politik”

Mandati i përfaqësuesit të lartë të BE-së është i bazuar në objektivat e politikave të BE-së në Kosovë. Këto politika përfshijnë rolin udhëheqës në ngritjen e stabilitetit në rajon me qëllim të ndërtimit të Kosovës në një vend të zhvilluar, demokratik dhe shumetnik me një bashkëpunim paqësor me fqinjët e saj. Është detyrë e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian që t’ju ofrojë autoriteteve kosovare këshillat dhe përkrahjen e BE-së në procesin politik dhe që të promovojë një bashkërendim të përgjithshëm të pranisë së BE-së në Kosovë. Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian gjithashtu i ofron udhëzime të politikës vendore shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX, dhe kontribuon në zhvillimin dhe konsolidimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë. Pieter Feith njëkohësisht ka edhe një mandat tjetër, që është mandati i përfaqësuesit civil ndërkombëtar: www.ico-kos.org



Personi kontaktues: Julia Rueter, julia.rueter@eusrinkosovo.eu, +381 38 2044 316, +377 44 509 760

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian | www.delprn.ec.europa.eu

Udhëheqësi: Renzo DAVIDDI

“Përkushtimi për reformim”

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë luan rolin kryesor në realizimin e agjendës evropiane në Kosovë me qëllim promovimin e përfundimit të Kosovës me Bashkimin Evropian. Kjo zyrë është përgjegjëse për udhëheqjen e reformave përmes politikave të rregullta, dialogut teknik dhe monitorimit të përparimit të Kosovës. Zyra Ndërlidhëse e KE-së ka një bashkëpunim të afërt me të gjitha palët e interesit, duke i ndihmuar kështu Kosovës në rrugën e saj drejt integritetit në BE. Roli i kësaj zyre përfshinë përdorimin e instrumenteve për zgjerim në kuadër të procesit të stabilizimit asociimit dhe forcimit të integritetit rajonal dhe evropian të Kosovës. Kjo zyrë gjithashtu bën menaxhimin e një numri të asistencave të konsiderueshme për fuqizimin e institucioneve, zhvillimin e ekonomisë dhe realizimin e standardeve evropiane. Në vitin 2010, Komisioni Evropian filloi një proces që duhet të shpie në lëvizjen eventuale pa viza për qytetarët e Kosovës dhe ka filluar përgatitjet për një marrëveshje gjithëpërfshirëse për tregti.



Personi kontaktues: Maja Pavlovic, maja.pavlovic@ec.europa.eu, + 381 38 51 31 253
Fjolla Çeku, fjolla.ceku@ec.europa.eu, +381 38 51 31 327,

Misioni i EULEX-it në Kosovë | www.eulex-kosovo.eu

Udhëheqësi: Xavier Bout de Marnhac

“Përkushtimi operacional”

Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit (EULEX) është misioni më i madh civil që është organizuar deri më tani në kuadër të politikës së përbashkët për siguri dhe mbrojtje (CSDP). Synimi kryesor i këtij misioni është t’i ndihmojë dhe mbështesë institucionet e Kosovës nga fusha e sundimit të ligjit në progresin e tyre drejt qëndrueshmërisë, llogaridhënies dhe zhvillimit të fuqizimit të mëtejshëm të një sistemi të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë, policisë dhe doganës. Ky mision gjithashtu ka edhe disa kompetencave ekzekutive.

EULEX-i filloi punën më 9 dhjetor 2008 dhe ka një zinxhir të njësuar komandues për BE-në në Bruksel dhe vepron në kuadër të kornizës së përgjithshme të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara. EULEX-i ka përafërsisht 1650 punonjës ndërkombëtarë dhe 1170 vendas.



Personi kontaktues: Karin Limdal, karin.limdal@eulex-kosovo.eu, +386 43 78 6350